



Funded by
the European Union

Të papunë në pandemi

Analizë e shkurtër mbi numrin dhe
profilin e punëkërkuësve gjatë periudhës
mars 2020 - shkurt 2021



Të papunë në pandemi - analizë e shkurtër mbi numrin dhe profilin e punëkërkuësve gjatë periudhës mars 2020 – shkurt 2021

Maj 2021

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

- Përmbajtja
- 3** Përmbledhje Ekzekutive
- 5** Hyrje
- 5** Humbjet e vendeve të punës në industri të ndryshme
- 8** Shifrat rekorde të punëkërkuësve gjatë pandemisë
- 11** Masat mbështetëse për punëkërkuës dhe të punësuar
- 11** Kapacitetet modeste të zyrave të punësimit
- 13** Përfundime dhe rekomandime



Funded by
the European Union

KOSOVO 2.0

 INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Përmbledhje Ekzekutive

Që nga fillimi i pandemisë Covid-19 në mars të vitit 2020, kufizimet e lëvizjes dhe të zhvillimit të aktivitetit ekonomik patën ndikim të madh në ekonominë e Kosovës e posaçërisht në tregun e punës. Bruto produkti vendor (BPV), shkalla e punësimit, ajo e papunësisë, sikurse edhe qarkullimi i bizneseve në industri të caktuara, patën luhatje domethënëse.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e dytë të vitit 2020, rritja reale e BPV-së ra nga 1.3% në -9.3%, shkalla e punësimit ra nga 29.1% në 24.1%, dhe shkalla e papunësisë u rrit nga 25% në 27.2%.¹ Përveç efekteve të menjëhershme, Banka Botërore konstatoi se rritja e BPV-së në Kosovë kishte rënë për 6.9% gjatë vitit 2020, si pasojë e rënies së jashtëzakonshme të të hyrave nga mosardhja e diasporës si dhe investimeve të ulëta.²

Ndryshime të tilla pësoi edhe numri i punëtorëve në industri të ndryshme. Sipas të dhënave të Administratës Tatimore në Kosovë (ATK), industrinë që pësuau mesatarisht rënien më të madhe të punëtorëve mes viteve 2019-2020 ishin transporti dhe magazinimi (-2,668 punëtorë), administrimi publik (-1,509 punëtorë), tregtia dhe riparimi i mjeteve motorike (-1,406 punëtorë).³

Në të njëjtën kohë, edhe numri i punëkërkuesve aktiv u rrit, pjesërisht si rezultat i pushimit nga puna të një pjese të popullsisë si dhe nga masat emergjente fiskale që miratoi Qeveria Kurti, në mbështetje të atyre që regjistroheshin si të papunë pranë qendrave të punësimit.⁴ Më konkretisht, nga marsi në prill 2020, numri i punëkërkuesve aktiv u rrit për më shumë se 32 mijë, dhe nga prilli në maj u rrit për edhe rreth 35 mijë. Numri i punëkërkuesve aktiv vazhdoi të rritet deri në muajin shtator 2020, kur edhe arriti shifrën më të lartë të regjistruar - me mbi 198 mijë punëkërkues. Pas shtatorit, numri filloi të bie dhe në shkurt 2021 qëndronte në afro 106 mijë punëkërkues të regjistruar. Sa i përket profilit të punëkërkuesve, shumica i përkisnin grupmoshës 25-39 vjeç, burrat dhe gratë ishin pothuajse të barabartë në numër, kurse për nga niveli i shkollimit dominonin ata të pashkolluar dhe me shkollë fillore apo të mesme.⁵

Sipas Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), rritja e punëkërkuesve gjatë asaj periudhe supozohet të ketë qenë kryesisht si pasojë e masave të miratuara nga qeveria, e jo domosdoshmërisht nga një ngritje e menjëhershme e interesit për punësim. Kjo, për shkak se shumica e atyre që u regjistruan si punëkërkues gjatë asaj kohe, ende nuk kanë raportuar në këtë agjenci, edhe pse APRK kërkon nga ta të lajmërohen çdo tre muaj për të treguar statusin e tyre të punësimit dhe

1 “Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 2020,” Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).
Burimi: <https://bit.ly/3vzsT9g>; “Bruto Produkti Vendor TM3 2020,” ASK.
Burimi: <https://bit.ly/2PFDS1U>

2 “Europe and Central Asia Economic Update, Spring 2021: Data, Digitalization, and Governance,” Banka Botërore, faqe 129. Burimi: <https://bit.ly/3xzWlhm>

3 Të dhëna të dërguara nga Administrata Tatimore e Kosovës për periudhën janar 2019 – shkurt 2021

4 Pako Emergjente Fiskale. prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/3tqutcW>

5 Të dhëna të dërguara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës për periudhën janar 2020 – shkurt 2021

të këshillohen tutje nëse ende nuk kanë gjetur punësim. Gjatë vitit 2020, APRK vendosi t'i bëjë jo aktiv një pjesë të punëkërkesve, të cilët nuk ishin lajmëruar për së paku tre muaj pas regjistrimit si punëkërkes, gjë që mund ta ketë shkaktuar pjesërisht rënien e punëkërkesve nga fundi i vitit 2020.

Përveç masës specifike në mbështetje të punëkërkesve të rinj, gjatë vitit 2020, qeveria miratoi një sërë masash tjera në mbështetje të tregut të punës në përgjithësi. Si rezultat i pakos emergjente fiskale të miratuar në mars 2020, përfitues kishte edhe prej individëve që mbështeten nga skema sociale, atyre që punonin në sektorë esencial, dhe atyre që humbën punën gjatë asaj kohe.⁶ Më tej, gjatë muajit gusht 2020, u aprovua edhe Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike, që ndër masa tjera synoi edhe rritje të punësimit, në veçanti të grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim dhe të rinjve.⁷

Në këtë studim, Instituti GAP ka analizuar punëkërkesit sipas një perspektive më të detajuar të karakteristikave të tyre si mosha, gjinia, apo niveli i edukimit gjatë periudhës një vjeçare mars 2020 – shkurt 2021. Për më tepër, ky studim merr për bazë edhe sfidat dhe nevojat e Agjencisë së Punësimit, e cila është përballur direkt me numrin e madh të punëkërkesve gjatë tërë vitit 2020.

Me qëllim të përmirësimit të tregut të punës në përgjithësi, Instituti GAP rekomandon që Agjencia e Punësimit në Kosovë të ketë ngritje të kapaciteteve që të mundësojë shtimin e punësimit, sidomos për grupe të caktuara dhe të ndjeshme punëkërkesish. Po ashtu, sugjerohet që agjencia vazhdimisht të ketë mundësi mbledhjen e të dhënave më të hollësishme rreth statusit të punësimit të punëkërkesve të regjistruar, dhe që të ketë mundësi të vazhdueshme trajnimit apo orientimi në karrierë për punëkërkes që të njoftohen për fusha punësimi në të cilat aktualisht ka apo pritet të ketë nevojë për punëtorë si dhe t'i ngrisin kualifikimet e tyre.

6 Pako Emergjente Fiskale. prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/3tqutcW>

7 Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, gusht 2020. Burimi: <https://bit.ly/3dFtZdR>

Hyrje


Agjencia e Punësimit në Kosovë, së bashku me 34 zyrat lokale për punësim, kanë përjetuar një vit jo të zakonshëm gjatë 2020. Një numër rekord i të papunëve janë paraqitur pranë tyre për tu regjistruar si punëkërkues. Në muajt e parë të pandemisë, Instituti GAP kishte publikuar një raport që parashihte efektet afatgjate të pandemisë në tregun e punës në Kosovë.⁸ Në prill 2020, numri i punëkërkuesve pranë Agjencisë së Punësimit u rrit për 40 herë në krahasim me muajin paraprak. Rritja do të vazhdonte përgjatë muajve në vazhdim, për të arritur një shifër rekorde prej mbi 198 mijë punëkërkuesish në shtator 2020. Por cili është numri i përgjithshëm i punëkërkuesve gjatë vitit të parë të pandemisë? Cili është profili i tyre? Cilat industri janë detyruar të largojnë më së shumti punëtorë? Duke përdorur të dhënat e Agjencisë së Punësimit, Administratës Tatimore, dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të punëkërkuesve në pandemi, me theks në numrin e tyre, aspektin gjinor dhe nivelin e shkollimit. Për më tepër, ky hulumtim analizon edhe kapacitetet e zyrave të punësimit për të ofruar shërbime për një numër enorm të punëkërkuesve.

Humbjet e vendeve të punës në industri të ndryshme

Kufizimet e lëvizjes dhe të zhvillimit të aktivitetit ekonomik pa dyshim se vunë një barrë të rëndë mbi tregun e punës në Kosovë. Shkalla e punësimit dhe ajo e papunësisë pësuan ndryshime të dukshme dhe qarkullimi i bizneseve në industri të caktuara pati rënie thelbësore.

Megjithatë, edhe pse fillimi i pandemisë sfidoi rëndë tregun e punës në Kosovë, ekonomia e Kosovës filloi të stabilizohet gradualisht. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e punësimit ra nga 29.1% gjatë tremujorit të parë në 24.1% gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, gjë që ishte gjithashtu më e vogël se sa ajo e tremujorit të dytë të vitit 2019 (periudhës para-pandemike) me 29.8%. Megjithatë, shkalla e punësimit u kthye në më shumë se sa niveli i mëparshëm qysh në tremujorin e tretë të vitit 2020 me 30.1%. Në anën tjetër, papunësia në Kosovë pësoi rritje prej 2.2 pikë përqindje prej tremujorit të parë të vitit 2020 (25%) në tremujorin e dytë (27.2%). Mirëpo, edhe kjo u rikthye në vlera para-pandemike në tremujorin e tretë me 24.6%.

Figura 1. Shkalla e papunësisë dhe ajo e punësimit gjatë viteve 2019 dhe 2020



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

8 "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në tregun e punës," Instituti GAP, qershor 2020. Burimi: <https://bit.ly/2QzGsXL>

Njëkohësisht, ndikimi i pandemisë u shfaq edhe në industri, ku bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në 2020 u raportuan afro 523 milionë euro apo 4% më pak qarkullim se sa në vitin paraprak.⁹ Në këtë rezultat më së shumti pati ndikim rënia e qarkullimit të aktiviteteve ekonomike si tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i mjeteve motorike (-302 milionë euro), transporti dhe magazinimi (-114 milionë euro), dhe akomodimi dhe shërbimi ushqimor (-45 milionë euro). Në anën tjetër, disa prej aktiviteteve shënuan rritje në qarkullim, si informimi dhe komunikimi (67 milionë euro), aktivitete shërbyese (26 milionë euro), furnizimi me ujë (18 milionë euro) si dhe aktivitete tjera të paraqitura në figurën 2.

Figura 2. Ndryshimi i deklarimit të qarkullimit në ATK për vitet 2019-2020

(në miliona euro)

Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve...	-302.4	
Transporti dhe magazinimi	-114.1	
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	-44.6	
Shërbimet administrative dhe mbështetëse	-44.1	
Industria perpunuese	-38.5	
Ndertimtaria	-28.6	
Artet, Argetimi dhe rekreacioni	-22.9	
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-17.9	
Aktivitetet e patundshmerise	-16.1	
Industria nxjerrëse	-11.7	
Person Fizik	-7.2	
Mungon aktiviteti	-6.5	
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-2.8	
Aktivitetet e trupave dhe organizatave nderkombetare	-0.1	
Aktivitetet e ekonomive familjare si punedhenes; Mallrat...		0.0
Arsimi		1.1
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i...		1.8
Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi		2.1
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale		7.9
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike		11.2
Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe...		17.8
Aktivitetet e tjera shërbyese		25.8
Informimi dhe komunikimi		66.9

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Njëkohësisht, industrinë e lartëpërmendura pësuan edhe ndryshime në numrin e punëtorëve gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin 2019. Tregtia me shumicë dhe pakicë kishte mesatarisht 1,406 punëtorë më pak, dhe transporti dhe magazinimi 2,668 punëtorë më pak. Megjithatë, për dallim, akomodimi dhe shërbimi ushqimor pa ngritje mesatare të punëtorëve për 1,239 gjatë vitit 2020 pavarësisht rënies së qarkullimit.

Rritja e numrit të të punësuarve për dallim prej rënies së qarkullimit në këtë industri mund të ketë qenë pasojë e Masës 14 të pakos emergjente fiskale, e cila ofronte mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistronin punëtorët me

⁹ Të dhëna të dërguara nga Administrata Tatimore e Kosovës për periudhën janar 2019 – shkurt 2021

kontratë pune së paku një vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik.¹⁰ Andaj, edhe pse shoqëritë tregtare, në këtë rast shoqëritë në industrinë e akomodimit dhe shërbimit ushqimor, angazhuan punëtorë të rinjë me asistencë financiare nga qeveria gjë që qoi në rritje të numrit të punëtorëve, humbjet në qarkullim të industrisë në përgjithësi mund të kenë qenë më të mëdha se sa përfitimet financiare nga qeveria, gjë që rezultoi në neto ulje të qarkullimit për atë industri.

Industritë që patën rritje të qarkullimit panë gjithashtu edhe rritje të numrit mesatar të punëtorëve gjatë vitit 2020 si për shembull informimi dhe komunikimi (+2,801 punëtorë), furnizimi me ujë (+2,262 punëtorë), si dhe aktivitetet e tjera shërbyese (+26,850 punëtorë). Duhet të vihet re se rritja e shënuar nga aktivitetet e tjera shërbyese prej 26,850 punëtorësh apo afro tre herë më shumë se sa vitin e kaluar vie kryesisht si pasojë e shtesave në pagë për punëtorë të punësuar gjatë muajve mars dhe prill 2020 që përfituan nga pako emergjente fiskale, të cilët u klasifikuan si punëtorë në atë industri. Prandaj, ajo rritje e numrit të punëtorëve vlen vetëm për muajt mars dhe prill 2020, kur ishte 356,524 në krahasim me po të njëjtën periudhë të vitit 2019 kur ishte 25,954. Nga maji 2020, numri i punëtorëve në këtë industri u rikthye në vlera të mëparshme.¹¹

Figura 3. Ndryshimi në numrin mesatar të punëtorëve sipas ATK për vitet 2019–2020

Aktivitetet e tjera shërbyese	26,850
Industria perpunuese	3,438
Informimi dhe komunikimi	2,801
Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe...	2,262
Ndertimtaria	1,612
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	1,239
Sherbimet administrative dhe mbështetese	1,141
Industria nxjerrëse	769
Aktivitetet e trupave dhe organizatave nderkombetare	72
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajer të kondicionuar	61
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	36
Arsimi	-9
Aktivitetet e patundshmerise	-109
Bujqesia;Pylltaria dhe Peshkimi	-169
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	-228
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-393
Artet, Argetimi dhe rekreacioni	-619
Person Fizik	-679
Mungon aktiviteti	-1,111
Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve...	-1,406
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i...	-1,509
Transporti dhe magazinimi	-2,668

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

¹⁰ Pako Emergjente Fiskale. Prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/3tqutcW>


¹¹ Sqarim përmes E-mail nga Valentina Bytyqi-Sefa, Udhëheqëse e Divizionit për Komunikim dhe Media, Administrata Tatimore e Kosovës, 16 prill 2021

Shifrat rekorde të punëkërkesve gjatë pandemisë

Ndryshimet në punësim u ndjenë edhe nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), ku sipas të dhënave nga ky institucion, gjatë një pjese të konsiderueshme të vitit 2020, numri total i punëkërkesve të regjistruar ishte jashtëzakonisht i lartë. Muaji prill i vitit 2020 ishte fillimi i shtimit të punëkërkesve me afro 147 mijë punëkërkes aktiv në total. Kjo mund të jetë ndikuar nga Masa 15 e pakos emergjentë fiskale, e cila ishte miratuar nga Qeveria Kurti gjatë muajit mars 2020, që parashihte një pagesë mujore në vlerë prej 130 euro për qytetarët të lajmëruar si të papunë pranë qendrave të punësimit (dhe që janë me kushte të rënda sociale apo që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës).

Në fakt, numri i punëkërkesve aktiv vazhdoi të rritet deri sa arriti kulmin në muajin shtator 2020 me më shumë se 198 mijë punëkërkes. Pas shtatorit, numri filloi të bie dhe në shkurt 2021 qëndronte në afro 106 mijë punëkërkes aktiv të regjistruar. Gjatë tërë kësaj periudhe, interesimi për punë nga gratë në krahasim me burrat ishte pothuajse i barabartë, duke qenë se gratë përbënin mesatarisht 45% të të gjithë punëkërkesve.¹²

Figura 4. Trendi i punëkërkesve aktiv total gjatë viteve 2020 dhe 2021




Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

¹² Të dhëna të dërguara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës për periudhën janar 2020 – shkurt 2021

Sipas të dhënave të fundit, në shkurt të vitit 2021, punëkërkesit aktiv në total ishin kryesisht burra që i përkasin grupmoshës 25-39 vjeç (22,662), ndërsa gratë të po asaj grupmoshe qëndronin në 19,197. Më së paku punëkërkes kishte të moshave mbi 55, ku vërehet një ndarje e njëjtë me më shumë burra (7,972) se sa gra (6,088).


Figura 5. Mosha dhe gjinia e punëkërkesve gjatë muajit shkurt 2021



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Në aspektin e arsimit të punëkërkesve aktiv, pjesa madhore apo 45% e këtyre punëkërkesve janë të pashkolluar, 20% kanë përfunduar shkollën fillore, 21% shkollë të mesme profesionale, 7% kanë gjimnaz të përfunduar, dhe rreth 8% janë me arsim të lartë. Punëkërkesit e pashkolluar, ata me arsim fillor dhe të mesëm janë kryesisht burra, ndërsa punëkërkesit me arsim të lartë (Baçelor apo Magjistraturë) janë kryesisht gra.

Figura 6. Niveli i arsimit të punëkërkesve aktiv gjatë muajit shkurt 2021



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Komunat me më së shumti punëkërkes aktiv gjatë muajit shkurt 2021 ishin Podujeva (8,944), Prizreni (8,103), dhe Peja (7,828), ndërsa më së paku kishin Parteshi (318), Juniku (248), dhe Mamusha (59). Për më tepër, nga këta punëkërkes, më shumë kishte gra se sa burra në komunat Pejë (53.5% e punëkërkesve total), Partesh (53.1%), Leposaviq (52.8%), Mitrovicë Veriore (52.6%), Podujevë (52.1%), Zveçan (51.7%), dhe Prishtinë (51.2 %) nga 38 komuna në total.

Tabela 1. Punëkërkesit aktiv gjatë muajit shkurt 2021 sipas komunave

Komuna	Gra	Burra	Totali
Podujevë	4,657	4,287	8,944
Prizren	3,558	4,545	8,103
Pejë	4,190	3,638	7,828
Ferizaj	2,136	2,910	5,046
Gjakovë	2,051	2,969	5,020
Vushtrri	2,416	2,588	5,004
Mitrovicë	2,184	2,663	4,847
Gjilan	2,269	2,556	4,825
Suharekë	1,997	2,402	4,399
Lipjan	1,968	2,392	4,360
Prishtinë	2,233	2,127	4,360
Skënderaj	1,869	1,960	3,829
Malishevë	1,339	2,100	3,439
Mitrovica Veriore	1,690	1,521	3,211
Leposaviq	1,516	1,354	2,870
Glllogoc	1,118	1,490	2,608
Dragash	1,002	1,588	2,590
Istog	833	1,449	2,282
Klinë	954	1,242	2,196
Fushë Kosovë	1,068	1,109	2,177
Viti	852	882	1,734
Zveçan	813	760	1,573
Shtime	577	897	1,474
Zubin Potok	703	718	1,421
Kaçanik	437	984	1,421
Obiliç	556	753	1,309
Kamenicë	479	794	1,273
Rahovec	336	865	1,201
Graçanicë	534	627	1,161
Shtërpc	481	570	1,051
Deçan	345	623	968
Novobërdë	417	545	962
Ranillug	337	416	753
Hani i Elezit	161	304	465
Klllokot	198	221	419
Partesh	169	149	318
Junik	116	132	248
Mamushë	14	45	59
Total	48,573	57,175	105,748

Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Masat mbështetëse për punëkërkuues dhe të punësuar

Gjatë vitit 2020, qeveria miratoi dy pako të ndryshme me masa të caktuara për të mbështetur tregun e punës ndër aspekte tjera ekonomike, të cilat u ndikuan nga pandemia. Më 30 mars 2020, qeveria miratoi pakon emergjente fiskale e cila përmbante 15 masa për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm të pandemisë në ekonominë e vendit.

Më saktësisht, qeveria ndau 20.6 milionë euro për pagesa shtesë të skemave sociale për së paku dy muaj me radhë, 22 milionë euro për pagesë shtesë për punonjësit e sektorëve esencial, të dyqaneve ushqimore, furrave, dhe barnatoreve, dhe ata të cilët humbën punën, dhe tre milionë euro për asistencë mujore për ata të cilët lajmërohen si të papunë në qendra të punësimit e që nuk përfitojnë nga Buxheti i Kosovës apo ata me kushte të rënda jetësore.¹³ Kjo e fundit mund të ketë ndikuar në rritjen e jashtëzakonshme të numrit të punëkërkuësve në muajt prill dhe maj 2020.

Me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë së Kosovës, gjatë muajit gusht 2020, qeveria aprovoi edhe Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike. Ndër masa të ndryshme që kanë për synim mbështetje për kërkesën agregate, prodhimin, likuiditetin financiar, të hyrat e sektorëve të caktuar etj., ka edhe masa të caktuara për mbështetje të tregut të punës dhe punësimit në përgjithësi. Më konkretisht, më shumë se 67 milionë euro u ndanë për subvencionim të pagave të punëtorëve të tanishëm dhe rritje të punësimit të grupeve të caktuara punëtorësh me gjasa më të ulëta për punësim dhe 5 milionë euro mbështetje financiare për punësim të të rinjve.¹⁴ Deri më tani, 47 milionë euro janë ekzekutuar si subvencion në pagë për punëtorë të sektorit privat, të cilët janë prekur nga pandemia, sikurse 6 milionë tjera për të njëjtën arsye që targetojnë grupe të caktuara biznesesh.¹⁵ Megjithatë, sipas një raporti të Institutit GAP, bizneset që kanë përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike, kanë përfituar në mënyrë proporcionale dhe jo sipas ndikimit të pandemisë në aktivitetin e tyre. Për shembull, nga 67 milionë euro për subvencionim të pagave kishin përfituar edhe industri si informimi dhe komunikimi dhe shëndetësia, të cilat kishin në të kundërtën rritje të qarkullimit financiar gjatë vitit 2020.¹⁶

Kapacitetet modeste të zyrave të punësimit

Sipas Departamentit të Tregut të Punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), rritja e punëkërkuësve gjatë vitit 2020 mund të jetë kryesisht pasojë e masave të miratuara nga qeveria në kuadër të pakos emergjente fiskale, e jo domosdoshmërisht e mbështetur nga një trend në rritje të numrit të punëkërkuësve apo të interesimit real për punësim.¹⁷ Kjo, për shkak se shumica e atyre që u regjistruan si punëkërkuues gjatë asaj kohe ende nuk kanë raportuar në Agjenci nëse kanë gjetur punësim. Sipas rregullave, punëkërkuësit duhet të lajmërohen në APRK çdo tre muaj, përndryshe largohen nga listat e të papunëve. APRK i informon për vendet e lira të punës vetëm ata që janë në listë apo ata që lajmërohen me rregull çdo tre muaj. Shkaktar i moslajmërimit të një pjese të

¹³ Pako Emergjente Fiskale. Prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/3tqutcW>

¹⁴ Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, gusht 2020. Burimi: <https://bit.ly/3dFtZdR>

¹⁵ Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr.08/08, 21 prill 2021. Burimi: <https://bit.ly/2SeFQHq>

¹⁶ "Programi dhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike," Instituti GAP, mars 2021. Burimi: <https://bit.ly/33GMrgo>

¹⁷ Intervistë me Muhamet Klinaku – Drejtor i Departamentit për Tregun e Punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, 23 prill 2021.

punëkërkuësve mund të jetë fakti që disa prej tyre mund të punojnë në sektorin joformal, gjë që iu jep mundësi atyre të regjistrohen si të papunë në APRK.

Duke parë mundësinë për përfitim nga pako emergjente fiskale, përfshirja e një pjese të punonjësve nga sektori joformal natyrisht se do ta rriste numrin e punëkërkuësve në mënyrë artificiale. Për më tepër, punëkërkuësit nuk largohen automatikisht nga sistemi edhe pse nuk lajmërohen çdo tre muaj pas regjistrimit.¹⁸ Megjithatë, gjatë vitit 2020, APRK vendosi t'i bëjë jo aktiv një pjesë të punëkërkuësve, të cilët nuk ishin lajmëruar për së paku më shumë se tre muaj pas regjistrimit si punëkërkuës,¹⁹ gjë që mund ta ketë shkaktuar pjesërisht rënien e punëkërkuësve nga fundi i vitit 2020. Në rast se do të mblidheshin të dhëna të hollësishme mbi statusin e punëkërkuësve pas regjistrimit fillestar, atëherë do ta kishim më të qartë ndikimin e APRK-së në punësim real që do të përshtatej pjesërisht me rënie të punëkërkuësve.

APRK pohon që gjatë vitit 2020 nuk ka pasur mbështetje buxhetore adekuate nga qeveria për t'u përballur me numrin e madh të punëkërkuësve të rinj.²⁰ Përveç asaj, kufizimi i numrit të stafit si pasojë e masave kufizuese dhe kërkesat e vazhdueshme për qasje në të dhëna kanë stërngarkuar këtë institucion. Pavarësisht ngarkesave me punëkërkuës, APRK në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrinë e Punëve të Brendëshme (MPB) ka lansuar një projekt të që të ndihmojë punëkërkuës të riatdhesuar të gjejnë punë, dhe të ofrojë trajnime për ata të riatdhesuar me nivel arsimor të kufizuar. Më konkretisht, projekti synon të subvencionojë pjesërisht ndërmarrje për të punësuar punëtorë me kontrata 12 mujore si dhe të ofrojë trajnime tre mujore për të riatdhesuarit pa përvojë pune.²¹

18 Ibid.

19 Ibid.

20 Ibid.

21 Programi për trajnim në punë dhe programi për subvencionim të pagës për të riatdhesuar, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3o5fDqE>; <https://bit.ly/3tB98gj>

Përfundime dhe rekomandime

Shtrëngimet ekonomike që erdhën si pasojë e pandemisë Covid-19 kanë prekur dukshëm ekonominë dhe në veçanti tregun e punës në Kosovë. Qysh në fillim të pandemisë në Kosovë, shkalla e punësimit ra nga 29.1% në 24.1%, dhe shkalla e papunësisë u rrit nga 25% në 27.2%. Disa prej industrive, sikurse transporti dhe magazinimi, u detyruan të bëjnë shkurtime të shumta të punonjësve të tyre, duke larguar mbi 2,600 punëtorë. Kjo ndihmon të shpjegojë se përse numri i punëkërkuësve në zyra të punësimit u rrit në çdo komunë të Kosovës. Në të njëjtën kohë, sipas Agjencisë së Punësimit në Kosovë (APRK), nga muaji mars në muajin maj 2020, numri i punëkërkuësve aktiv u rrit për më shumë se 67 mijë, dhe vazhdoi vazhdoi të rritet deri në muajin shtator 2020 me më shumë se 198 mijë punëkërkuës. Numri i tyre vazhdoi të jetë i lartë deri në fund të vitit 2020, kur Agjencia në fjalë filloi të i bëjë një pjesë të tyre jo aktiv pasi që nuk ishin lajmëruar në Agjenci sërish pas regjistrimit për t'u konsultuar rreth statusit të punësimit, gjë që kërkohet çdo tre muaj. Kjo lë për t'u kuptuar se masa e qeverisë për t'i mbështetur punëkërkuësit financiarisht shkaktoi një valë të madhe regjistrimesh gjatë asaj kohe.

Sa i përket karakteristikave të punëkërkuësve, edhe përgjatë vitit 2020, burra dhe gra kishte pothuajse në përmasa të njëjta. Mirëpo, shpërndarje të barabartë nuk kishte nga ana e shkollimit, ku punëkërkuësit ishin kryesisht të pashkolluar, me shkollë fillore apo të mesme, dhe nga ana e moshës, ku shumica iu përkisnin grupmoshës 25-39. Ndryshime u vërejtën edhe në shpërndarje gjeografike të punëkërkuësve, ku komunat si Podujeva, Prizreni dhe Peja mbizotëruan në numër të tyre.

Me qëllim të përmirësimit të tregut të punës dhe mbështetjen e punëkërkuësve, Instituti GAP rekomandon që:

Qeveria e Kosovës të mbështesë Agjencinë e Punësimit në Kosovë me ngritje të kapaciteteve operative, në mënyrë që të ketë lansim të rregullt të projekteve të punësimit për grupe të caktuara dhe të ndjeshme punëkërkuësish si gratë, të rinjtë, dhe ata me kushte të rënda ekonomike.

Qeveria e Kosovës të bashkëpunojë më Agjencinë e Punësimit në Kosovë për të mbledhur të dhëna të rregullta të statusit të punësimit të punëkërkuësve pas regjistrimit. Në këtë mënyrë do të mund të matej më mirë ndikimi i programeve të Agjencisë.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të ndihmojë t'i ngris kapacitetet për orientim në karrierë për studentë, të diplomuar, edhe për persona të pashkolluar apo vetëm me arsim të ulët me qëllim që të ata të njoftohen për fusha punësimi në të cilat aktualisht ka apo pritet të ketë nevojë për punëtorë pas studimeve të tyre. Si rezultat i kësaj, një pjesë e atyre të papunësuarve do të kenë mundësi më të mëdha për punësim në të ardhmen.





Funded by
the European Union

Projekti “Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar”
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0







Funded by
the European Union

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Të papunë në pandemi
Analizë e shkurtër mbi numrin dhe
profilin e punëkërkesve gjatë
periudhës mars 2020 - shkurt 2021